

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.05.2023*

**23.05.2023
Ora 11:20**

RENDI I DITËS

Shorti “Për caktimin e relatorit për kërkesën ankimore numër 74,75,76,77,78”.

PJESËMARRJA :

- **Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema**

Z. Y. Merkaj: Atëherë, përshëndetje të gjithëve! Sot në datën 23.05.2023 ora 11:20, zhvillohet seanca për caktimin e relatorit, për kërkesën ankimore numër 74,75,76,77,78. Duke qenë se procedura e shortit parashikohet në nenin 14 të rregullores së KAS. Kemi përgatitur 5 shirita letre ku kemi shënuar kërkesat ankimore nga 74 deri tek 78. Të cilat palosen edhe futen në gogla me peshë, ngjyrë dhe formë të njëjtë në një ene transparente. Duke qenë se anëtarët e KAS nuk janë të pranishëm, kanë autorizuar një përfaqësues të KQZ-së për të tërhequr goglat në emër dhe për llogari të tyre. Duke filluar nga rendi alfabetik rritës me zotin Elvin Lako, Elvis Çefa, Ilirjan Rusmali, Koli Bele dhe Ledio Braho. Të pestë goglat janë në enë transparente përzihen nga një përfaqësues i KQZ.

-Tërhiqet gogla -Vazhdojmë në emër dhe për llogari të:

Z. Ervin Lako: - kërkesa ankimore numër 75.

-Vazhdojmë në emër dhe për llogari të:

Z. Elvis Çefa: - kërkesa ankimore numër 78.


-Vazhdojmë në emër dhe për llogari të:

Z. Ilirjan Rusmali: -kërkesa ankimore numër 74.

-Vazhdojmë në emër dhe për llogari të:

Z. Koli Bele: -kërkesa ankimore numër 77.

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.05.2023*

Në fund, në emër dhe për llogari të:

Z. Ledio Braho: -kërkesa ankimore numër 76.

Në përfundim të procedurës së shortit relatori i kërkesës ankimore numër 75 është zoti Elvin Lako, relatori i kërkesës ankimore numër 78 është zoti Elvis Çefa, relatori i kërkesës ankimore numër 74 është zoti Ilirjan Rusmali, relatori i kërkesës ankimore numër 77 është zoti Koli Bele dhe relatori i kërkesës ankimore numër 76 është zoti Ledio Braho. Me kaq përfundojmë edhe procedurën e shortit për caktimin e relatorëve për kërkesat ankimore. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.05.2023*

23.05.2023
Ora 12.36

RENDI I DITËS

**“Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 65, subjekti ankues Partia Lëvizja e
Legalitetit”**

PJESËMARRJA:

- **KAS:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,
Z. Ledio Braho
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj
- **Parti politike** PLL (Z. Ferit Nelaj)
- **Të tjerë:** KRIIK

Z. E. Lako: Deklarojmë të çelur seancën e sotme për shqyrtimin në themel të kërkesës ankimore nr. 65 të depozituar në datën 20.5.2023 nga subjekti zgjedhor Partia Lëvizja e Legalitetit me objekt “Kundërshtimin e vendimit nr. 325, datë 17.05.2023 të KZAZ-së nr. 19, “Për miratimin e tabelës përmbledhësve të rezultateve për zgjedhjen e këshillin e Bashkisë Dibër”. Sipas shortit të hedhur, relator i kësaj çështjeje jam zgjedhur unë, Elvin Lako. Para se të fillojmë shqyrtimin e çështjes, verifikojmë palët pjesëmarrëse. Është e pranishme trupa e KAS-it e përbërë nga katër anëtarë sot, një anëtar mungon për arsye objektive. Është i pranishëm sekretari i Përgjithshëm që përfaqëson administratën e KQZ-së.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.05.2023*

Gjithashtu është e pranishme edhe pala ankuese, e përfaqësuar në këtë seancë nga...
Ju lutem prezantohuni.

Z. F. Nelaj: Përfaqësuesi i Partisë Lëvizja e Legalitetit, Ferit Nelaj.

Z. E. Lako: Faleminderit! Para se të fillojmë, ka ndonjë kërkesë paraprake për anëtarët e KAS-it ose ndonjë kërkesë tjetër që mund të keni për konflikt interesi? Jo.

Z. F. Nelaj: Jo.

Z. E. Lako: Edhe anëtarët e KAS-it nuk kanë. Vazhdojmë me shqyrtimin në themel të çështjes. Ju lutem, zoti Merkaj, shkurtimisht dy fjalë në lidhje me këtë kërkesë.

Z. Y. Merkaj: Në seancën e djeshme nga KAS-i është urdhëruar administrata e KQZ-së që të sjellë kutinë e votimit për këshillin dhe për kandidatin, si dhe materialet zgjedhore të qendrës së votimit, e cila është objekt ankimi, qendra e votimit Maqellarë me nr. 1100. Gjithashtu, është marrë nga protokollit i KQZ-së edhe libri i protokolleve të mbledhjeve të KZAZ-së, që pasqyron edhe faktin e marrjes në dorëzim nga anëtarët e KZAZ-së të kutive të të gjithë KZAZ-së. I disponojmë. Mendojmë që i kemi plotësuar urdhërimet e KAS-it dhe po jua vëmë në dispozicion. Kutia ka ardhur këtu dhe numrin e protokollit e kemi.

Z. E. Lako: Para se të kalojmë tek administrimi që do t'i bëjmë kutisë së votimit, dy fjalë në lidhje me çështjen, pra cili është konflikti, për çfarë ankohet.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.05.2023*

Z. Y. Merkaj: Partia lëvizja e Legalitetit ka ankimuar dhe kundërshton vendimin e miratimit të tabelës përmbledhëse të rezultatit të KZAZ-së nr. 19, pasi pretendon se nuk janë pasqyruar të gjitha rezultatet e të gjitha qendrave të votimit dhe konkretisht qendra e votimit nr. 1100 nuk është pasqyruar në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve. Në ankimin e saj Partia Lëvizja e Legalitetit pretendon se në qoftë se do të futet ky rezultat i kësaj qendre votimi, atëherë do të marrin një mandat.

Z. E. Lako: Cila është arsyeja që nuk është përfshirë?

Z. Y. Merkaj: Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe libri i protokollit të KZAZ-së, grupi i marrjes në dorëzim që në fillim e ka quajtur këtë kuti për këshillin e Bashkisë Dibër të parregullt, sepse është dëmtuar kodi i pestë, atje ku futen fletët e votimit. Ka vendosur shiritin dhe etikën “Kuti e parregullt” dhe në bazë të nenit 115, pika 3, të Kodit Zgjedhor për asnjë arsye kjo kuti, në e është shpallur e parregullt, nuk mund t’i nënshtrohet dhe nuk mund të futet në tabelën përmbledhëse të rezultatit.

Z. E. Lako: Faleminderit! Pra, konflikti është që kjo kuti është vlerësuar e parregullt, ndërsa ankuesi pretendon që kjo duhet të ishte përfshirë në... Ta dëgjojmë ankuesin shkurtimisht në lidhje me objektin sot. Ato që nisët të thoshit dje, do t’i thoni sot. Cili është pretendimi juaj, që ka ndikuar në rezultatin e këshillit bashkiak për këtë bashki.

Z. F. Nelaj: Pretendimi ynë është sepse nga rezultati që kemi sipas tabelës përmbledhëse për qendrën e Peshkopisë, na rezulton që diferenca pa hapjen e kësaj

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.05.2023*

kutisë së fundit, na penalizon për një mandat të dytë për këshillin bashkiak. Kështu që kërkojmë të shqyrtohet nga ana juaj.

Z. E. Lako: Dakord, nëse kjo do të numërohej, mund të ndikojë, thoni ju, por sipas Kodit Zgjedhor një kuti që vlerësohet e parregullt, nuk numërohet. Ju keni ndonjë pretendim pse ju mendoni që kjo kuti duhet të vlerësohet e rregullt? Pra, keni ndonjë pretendim në lidhje me këtë fakt?

Z. F. Nelaj: Gjykojmë që vendimi për kutinë është e rregullt apo jo, përderisa nuk e ka marrë vendimin KZAZ-ja përkatëse, të njihet nga ana juaj.

Z. E. Lako: KZAZ-ja përkatëse e ka marrë vendimin, e ka quajtur të parregullt dhe nuk e ka përfshirë. Ju e kundërshtoni këtë vendim para KAS-it. Keni ndonjë argument pse e kundërshtoni vendimin e KZAZ-së për të mos e numëruar? Pse është e rregullt për ju? Mirë. Faleminderit! Ka ndonjë pyetje nga anëtarët e KAS-it? Po, zoti Braho.

Z. L. Braho: Kam një pyetje për administratën: ka ndonjë ankim tjetër në lidhje me këtë qendër votimi nga ndonjë subjekt tjetër zgjedhor?

Z. Y. Merkaj: Deri në këtë moment jo.

Z. L. Braho: Deri tani jo. Po vendim KZAZ-je ka për këtë, apo vetëm dy anëtarët që kanë pritur materialet zgjedhore nga KQV-ja?

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.05.2023*

Z. Y. Merkaj: Atëherë procedura është e tillë, të gjitha materialet vijnë nga qendra e votimit drejt KZAZ-së. KZAZ-ja ngre grupet e marrjes në dorëzim, si rregull janë anëtarët e KZAZ-së. Çdo anëtar i KZAZ-së shikon, janë të krahëve të kundërt të partive politike, presin kutitë e votimit dhe, kur mungon, janë dy tre cilësime në nenin 115 të Kodit Zgjedhor, kur kutisë i mungon një vulë sigurie, kur është e hapur dhe lë hapësirë për të futur fletët e votimit, në këto raste kutia deklarohet që në fillim e parregullt.

Z. L. Braho: Deklarohet nga ata dy anëtarët pritës apo me vendim KZAZ-je?

Z. Y. Merkaj: Mblidhet KZAZ-ja, merr vendim KZAZ-ja dhe vendoset etiketa “Kuti e parregullt”.

Z. L. Braho: Po KQZ-ja, ju si përfaqësues i Komisionerit keni ndonjë mendim në lidhje me faktin që a është e rregullt, a është e parregullt, sepse ju normalisht jepni mendim?

Z. Y. Merkaj: Nuk i futet KQZ-ja.

Z. L. Braho: Pra, nuk keni asnjë mendim në lidhje me këtë?

Z. Y. Merkaj: Nuk i futet KQZ-ja për sa kohë ata e kanë cilësuar të parregullt, sepse është dëmtuar vula e sigurisë, ku mbyllet kapaku ku hidhen fletët e votimit dhe pretendohet që mund të jenë hedhur fletë votimi tek ajo.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.05.2023*

Z. L. Braho: Dakord.

Z. E. Lako: Po, zoti Rusmali.

Z. I. Rusmali: Janë mbajtur shënimet nga KZAZ-ja, i kemi procesverbalin e konstatimit?

Z. Y. Merkaj: Po, librin e protokollit e kemi.

Z. I. Rusmali: Çfarë thuhet, mund të na i citoni ju? Mund të na e servirni si provë?

Z. Y. Merkaj: Atëherë, në datën 14.5.2023, ora 22.00, përfundoi marrja në dorëzim e kutive. Nga marrja në dorëzim u konstatua se kutia e QV-së nr. 1100 e këshillit bashkiak është e dëmtuar gjatë transportit, i është këputur vula e kallçkut te vula kryesore. U sistemuan kutitë...kaq thotë. Në orën 1.03. Ky është i KZAZ-së dhe është firmosur nga 6 anëtarë.

Z. E. Lako: Zoti Ylli, mund ta kemi ne një kopje të librit të protokolleve të mbledhjeve? Ka marrë ndonjë vendim KZAZ-ja për këtë kuti?

Z. Y. Merkaj: E ka deklaruar te libri i protokollit.

Z. E. Lako: Thjesht e ka deklaruar te libri, nuk ka ndonjë vendimarrje.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.05.2023*

Z. Y. Merkaj: Libri i protokollit të KZAZ-së.

Z. L. Braho: Të KQV-së.

Z. Y. Merkaj: Është te materialet. I kanë vendosur etiketën lart dhe nuk e kemi hapur ta shohim, sepse ia kemi lënë KAS-it ta shikojë. Në qoftë se mund ta mbikëqyrim dhe mund ta konstatojmë është e dëmtuar apo jo.

Z. I. Rusmali: Ju si palë ankuese keni për këtë procedurë ndonjë kontestim? Nuk keni asnjë koment për këtë procedurë.

Z. F. Nelaj: Thjesht gjykimi ynë supozohet që kutia është e rregullt.

Z. E. Lako: Zoti Merkaj, si konkluzion, ju çfarë kërkon si administratë?

Z. Y. Merkaj: Ne kërkojmë rrëzimin e kërkesës për miratimin e tabelës dhe lënien në fuqi të KZAZ-së pa numëruar qendrën e votimit nr. 1100, e cila nuk është përfshirë në tabelën e rezultateve.

Z. E. Lako: Ju si palë ankuese çfarë kërkon nga KAS-i përfundimisht?

Z. F. Nelaj: Ne kërkojmë që të shqyrtohet dhe të hapet kutia nëse është e mundur.

Z. E. Lako: Faleminderit! Do të tërhiqemi për vendim dhe për 5 minuta do t'ju thërrasim përsëri.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.05.2023*

Rifillon seanca
Ora 13.18

Z. E. Lako: Fillojmë këtë seancë. Në përfundim të hetimit administrativ KAS vendosi:

- Rrëzimin e kërkesës ankimore të paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Lëvizja e Legalitetit. Lënien në fuqi të vendimit nr. 325, datë 17.5.2023 të KZAZ-së nr. 19, bashkia Dibër “Për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjet për këshillin bashkiak Dibër”.
 - Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
 - Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Administrativ brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.
- Me kaq e deklarojmë të mbyllur këtë seancë.

Vendimi nr. 125

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.05.2023*

**23.05.2023
Ora 13:24**

RENDI I DITËS

**“Për shqyrtimin paraprak të kërkesës ankimore nr. 63, subjekti ankues Partia
Aleanca Demokristiane”.**

PJESËMARRJA :

KAS: Z. Elvin LAKO, Z. Elvis ÇEFA, Z. Ilirjan RUSMALI,
Z. Ledio BRAHO.

Stafi KQZ: Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj, E. Mema.

Parti Politike: Partia ADK

Të tjerë: KRIIK.

Z. E. Çefa: Mirëdita të gjithëve, atëhere riçelim dhe njëherë seancën për vlerësimin paraprak të kërkesës ankimore me numër 63, të paraqitur nga Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë, me objekt kundërshtimin e vendimit të KZAZ-së numër 7, me numër 260 të vendimit, datë 16 maj 2023, për miratim të tabelës përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjen e këshillit të Bashkisë Pukë, rivlerësimin e votave të vlefshme dhe të pavlefshme të subjekteve në kutitë e votimit, për të gjitha QV e njësisë numër 7, Bashkia Pukë, qarku Shkodër, ndryshimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit për këshillin e Bashkisë Pukë, duke përfshirë në të rezultatin e dalë nga procesi i rivlerësimit të votave. Përpara se të fillojmë, të verifikojmë prezencën eshë prezent trupa e KAS-it në përbërje me katër anëtar, sikur ishte dhe dje, është prezent Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së dhe administrata e tij, është prezente dhe pala ankuesë. Ju lutem prezantohuni, Kryetari i Partisë, zoti Bushati, dhe përfaqësuesi tjetër me autorizim Petrit Dedaj, po që jeni dhe kandidat për në këshillin Bashisë Pukë.

**Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.05.2023*

Z. P. Nelaj: Në listën shumëemërore të këshillit të Bashkisë Pukë.

Z. E. Çefa: Faleminderit. Atëhere sikur se jeni në dijeni dhe ne jua kthyer për një rregullim të tabelës, a mund të na thoni ju lutem çfarë keni ndryshuar, me mikrofon që ta regjistrojmë.

Z. P. Nelaj: Nga ana jonë është bërë rregullimi sipas kërkesave ligjore, pra kemi kërkuar rivlerësimin e votave të vlefshme dhe të pavlefshme të subjekteve zgjedhore në kutitë e votimit për këshillin e Bashkisë Pukë, për Qëndrat e Votimit të cilësuar sipas kërkesës dhe kemi kërkuar ndryshimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve për këshillin e Bashkisë Pukë, duke përfshirë në të rezultatin e dalë nga procesi i rivlerësimit të votave.

Z. E. Çefa: Po dakord, zoti Sekretar i Përgjithshëm, ndonjë opinion.

Z. Y. Merkaç: Po, në mbledhjen e djeshme siç e thatë edhe ju është kthyer kërkesa për plotësim, është depozituar kërkesa e plotësuar, shikojmë që vetëm është hequr fjala e vlerësimit dhe pjesa tjetër e objektit është e njëjtë, kështu që mendojmë që është prapë e paplotësuar, kërkojmë rrëzimin e kërkesës.

Z. E. Çefa: Faleminderit! Atëhere subjekti ankimues edhe një herë ju lutem, nuk e di sa keni qënë të vëmendshëm dhe, ne u shprehëm qartë lidhur me modifikimin, pra ju udhëzuam qartësisht për të modifikuar objektin e kërimit, sepse ju vazhdoni të keni të njëjtin objekt kërkitimi, pra keni përdorur fjalë të tjera por në thelb është i njëjti, rivlerësimi i votave të vlefshme dhe të pavlefshme në të gjithë qarkun, kështu

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.05.2023*

e ke të shkruar këtu, në të gjithë Qendrat e Votimit të KZAZ-së numër 07. Ndërkohë që ne dje qartësisht ju specifikuam që kjo është diçka që ne nuk mund ta bëjmë apriori me kërkesën tuaj, ju duhet të kërkonit vetëm ndryshimin e tabelës përmbledhëse, në ato qendra, përse i përket rezultatit në ato Qendra Votimi, ku ju do keni prova që rezultati është ndryshuar në kundërshtim me ligjin. Ne do hetojmë mbi ato tuajat dhe më pas do shohim nëse ka ndryshim në tabelë apo jo, pra ky duhet të ishte. Nëqoftë se ju më thoni që jeni dakord me këtë që thashë unë po e konsiderojmë që ndërruar në seancë, e sqaruar në seancë objektin.

Z. P. Nelaj: Jam dakord me këtë që thoni ju dhe unë kam cilësuar Qendrat e Votimit për të cilat kërkoj rihapje, kërkoj rivlerësimin. 7 Qendra Votimi.

Z. E. Çefa: Dakord, por në objekt ke thënë, të gjitha Qendrat e Votimit të KZAZ-së numër 7, Bashkia Pukë, tani ne e shohim atë, e lexojmë, megjithatë do t'i përmbahemi kësaj që unë sapo thashë, apo jo? Do ta konsiderojmë që ju e saktësuat në seancë objektin e kërimit. Dakord?

Z. P. Nelaj: Dakord.

Z. E. Çefa: Atëherë KAS i konsultuar në vend vendosi kalimin për shqyrtim, seanca do të zhillohet, kur e keni të përshtatshme? Për nesër gjithmonë.

Z. P. Nelaj: Atëhere i nderuar, unë kam sjell materialet filmike për t'ja bërë të qartë trupës, për cënimin e procesit zgjedhor dhe ndryshimin e votave, vlerësimin e votave të pavlefshme dhe të një subjekti zgjedhor tjetër, për të cilat unë do i paraqes para jush. Në momentin që ju kërkonit.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.05.2023*

Z. E. Çefa: Caktimi i seancës së shqyrtimit për nesër, ku ju do t'i keni të gatëshme dhe këto provat për t'i paraqitur para KAS-it, është në rregull për ju në orën 12:30?

Z. P. Nelaj: Unë jam dakord.

Z. E. Çefa: Atëhere nesër në orën 12:30 është seanca për shqyrtimin në themel të kërkesës ankimore numër 63.

Z. P. Nelaj: Dakord, faleminderit.

Z. E. Çefa: Me kaq kjo seancë deklarohet e mbyllur, faleminderit.

Z. P. Nelaj: Ju përsënder!

Vendimi nr. 126

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.05.2023*

23.05.2023

Ora 13:30

RENDI I DITËS

“Për shqyrtimin paraprak të kërkesës ankimore nr. 68, subjekti ankues: Partia Aleanca Demokristiane”.

PJESËMARRJA :

KAS: Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,
Z. Ledio Braho.

Stafi KQZ: Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema.

PARTI POLITIKE: Partia ADK (Z. Zef Bushati, Z.Viktor Apostoli)

Të tjerë: KRIIK

Z. I. Rusmali: Mirë, riçelim seancën për shqyrtimin e kërkesës ankimore numër 68, paraqitur nga Partia Aleanca Demokristiane, me objekt kundërshtimin e vendimit numër 86, datë 16.05.2023, për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit të këshillit bashkiak, të Bashkisë Përmet, dhe hartimin e tabelës së re përmbledhëse pas këqyrje të materialit zgjedhor sipas kësaj kërkesë ankimore, ky është objekti i modifikuar pasi ne i dhamë 24 orë afat subjektit për të bërë ndryshimet e nevojshme. Trupa e KAS-it në përbërje të katër anëtarëve, në mungesë të kolegut Bele arsye objektive, prezent është subjekti zgjedhor Partia Aleanca, përfaqësuar nga Kryetari i Partisë, zoti Zef Bushati, dhe, apo s’kemi njeri tjetër.

Z. Z. Bushati: Kemi, kemi. Kemi dhe kandidat për këshilltarë.

Z. V. Apostoli: Viktor Apostoli.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.05.2023*

Z. I. Rusmali: Dakord, mirë faleminderit. Është Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së bashkë me ekipin e tij. Zoti Merkaj, në vlerësimin tuaj ku jemi me.

Z. Y. Merkaj: Në seancën e djeshme u la për plotësim kërkesa për saktësimin e objektit të KZAZ-së së Përmetit, Bashkia Përmet. Nga verifikimi konstatojmë që është bërë plotësimi i elementëve të formës dhe ë përmbajtjes sipas porosisë së KAS-it, kështu që kërkesa të kalojë për shqyrtim. Faleminderit!

Z. I. Rusmali: Mirë, ndonjë pyetje nga kolegët? Nuk ka pyetje nga kolegët. Ju keni gjë për të thënë në lidhje me këto elementë formal, apo se keni të nevojshme?

Z. V. Apostoli: Të vij personi që ka qenë prezent atje që i di më mirë detajet, ne i kemi të deleguara nga..


Z. I. Rusmali: Nuk keni gjë për të thënë për elementët formal, ju jemi dakord që të kalojë për shqyrtim apo jo?

Z. V. Apostoli: Të kalojë për shqyrtim, po.

Z. I. Rusmali: Dakord, mirë atëhere KAS i konsultuar në vend vendos pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore të paraqitur nga Partia Aleanca Demokristiane, kërkesës numër 68, dhe cakton seancën e shqyrtimit në themel të saj, nesër datë 24 maj 2023, ora 13:30. Me kaq e deklaroj seancën paraprake të mbyllur dhe shihemi nesër ne ora 13:30.

Vendimi nr. 127

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.05.2023*

23.05.2023

Ora 13:35

RENDI I DITËS

“Për pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 73, datë 22.05.2023 të depozituar nga ‘Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë’”.

PJESËMARRJA:

- **KAS:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,
Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaj, Znj. I. Osmani,
- **Parti Politike** PADK (Z. Zef Bushati)
- **Të tjerë:** KRIIK

Z. E. Lako: Mirë, çelim seancën e Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve për çështjen ankimore numër 73 të datës 22.05.2023 të paraqitur nga Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë. Me objekt: Kundërshtim i vendimit numër 196, datë 18.05.2023 të KZAZ numër 80, “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjen e këshillit të bashkisë Gjirokastrë”. Relator i kësaj seance jam zgjedhur unë Elvin Lako sipas shortit të hedhur në datën 22 maj. Të pranishëm janë katër anëtarët e Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, Sekretari i Përgjithshëm, administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe për palën ankuese është kryetari i partisë. Ai do e përfaqësojë?

Z. Z. Bushati: Po, Zef Bushati.

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.05.2023*

Z. E. Lako: Faleminderit! Atëherë shkurtimisht zoti Sekretar i Përgjithshëm dy fjalë në lidhje me rrethanat e çështjes përsa i përket plotësimit të elementëve të formës dhe të përmbajtjes për këtë kërkesë.

Z. Y. Merkaç: Faleminderit! Pranë Komisionit Qendor të Zgjedhjeve është paraqitur kërkesa ankimore numër 73 me ankues Partia Aleanca Demokristiane Shqipërisë e cila ankimon vendimin e KZAZ-së për Bashkinë Gjirokastër dhe thotë “Kundërshtim i vendimit numër 196, datë 18.05.2023”. Nga verifikimi i elementëve formal të kërkesës konstatohet se i përmbush të tre elementët e parashikuar në nenin 130 të Kodit Zgjedhor. Kompetencën e KAS-it, legjitimiteti i ankuesit si dhe forma e bashkëlidhur kërkesës e cila është tabela e rezultateve dhe vendimi për miratim të tabelës së rezultatit. Gjithashtu edhe afatin e paraqitjes së ankesës, është brenda afatit të përcaktuar në ligj. Në këto kushte i kërkojmë kalimin e kërkesës në seancë për shqyrtim. Faleminderit.

Z. E. Lako: Faleminderit zoti Merkaç. Pala ankuese ka ndonjë koment në këtë fazë në lidhje me plotësimin e elementëve të formës dhe të përmbajtjes? Ju mendoni që i plotëson?

Z. Z. Bushati: Ashtu mendoj.

Z. E. Lako: Faleminderit.

Z. I. Rusmali: Të saktësojë objektin e kërkesës.

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.05.2023*

Z. E. Lako: Atëherë në lidhje me subjektin e kërkesës zoti Bushati, ju keni kërkuar shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve. Në fakt po ti hyjmë përmbajtjes së kërkesës ankimore rezulton që ju kërkoni rivlerësim të votave në tre QV për shkak të atyre...

Z. Z. Bushati: Po e vërtetë është!

Z. E. Lako: Kështu ju duhet që ta rishikoni edhe njëherë, pra ta ripunoni objektin e këtij ankimi. Pra jo të kërkoni pavlefshmërinë, shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në këto QV-të por ndryshimin e rezultatit në këto QV pas rinumërimit.

Z. Z. Bushati: Po!

Z. E. Lako: Jeni dakord me këtë riformulim? Mirë.

Z. Z. Bushati: Po dakord jemi sepse ç'është e vërteta pakënaqësia jonë është tek ato tre qendra është specifikuar një gjë e tillë. Kokën pastaj, mënyrën se si e kemi konceptuar ka gabim, mund ta korigjojmë atë fillimin e kërkesës tonë.

Z. E. Lako: Dakord atëherë me këtë korigjim KAS vendosi:

- Kalimin e kësaj çështje për shqyrtim.
- Seanca për shqyrtimin në themel të kësaj kërkesë do të zhvillohet nesër më datë 24.05.2023, ora 14:00. Faleminderit. Me kaq deklarohet e mbyllur kjo seancë.

Z. Z. Bushati: Faleminderit edhe ju. Faleminderit zoti Ylli.

Vendimi nr. 128

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Seancë publike e Komisionit të
Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.05.2023*

**23.05.2023
Ora 13:39**

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për shqyrtimin paraprak të kërkesës ankimore nr. 69, subjekti ankues, Fryma e Re Demokratike”.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin LAKO, Z. Elvis ÇEFA, Z. Ilirjan RUSMALI, Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj, E. Mema.
- **Parti Politike:** FRD
- **Të tjerë:** KRIIK

Z. E. Çefa: Atëherë mirëdita, çelim edhe njëherë seancën e radhës për vlersimin e elementëve të formës dhe të përmbajtjes, të kërkesës ankimore numër 69, regjistruar në KQZ në datën 22 maj 2023, me ankimes Naçi Lato, përfaqësues Fryma e Re Demokratike, me objekt kërkesë për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në të gjitha qendrat e votimit të KZAZ-së numër 78 dhe kundërshtimi i vendimit të KZAZ-së, (numër, datë nuk është) kërkesa nuk i ka të bashkëlidhur as vendimin që ju ankimoni, megjithatë verifikojmë prezencën, është prezent trupa e KAS-it në përbërje të së cilës janë 4 anëtarë për shkak të mungesës për arsye objektive të një anëtari, ky fakt nuk e vë në vështirësi për vendimarrje KAS-in për arsye se forumi i nevojshëm konsiderohet i bërë, është prezent pala ankimuese përfaqësuar nga vetë zotëria, ju lutem prezantohuni.

**Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI**

Seancë publike
Komisioni Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.05.2023

Z. N. Lato: Po, Naçi Lato!

Z. E. Çefa: Faleminderit, është prezent dhe Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së dhe stafi i tij. Atëherë shkurtimisht zoti Sekretar i Përgjithshëm për elementët e formës dhe të përmbajtjes së ankimit.

Z. Y. Merkaç: Po, pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është paraqitur kërkesa ankimore numër 69, me ankues Naçi Lato, përfaqësues i Partisë Fryma e Re Demokratike me objekt rinumërimin e kutive të këshillit bashkiak KZAZ-ja numër 78 dhe kërkesë për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve, nga verifikimi paraprak i kërkesës konstatohet se nuk i plotëson elementët formal të kërkesës ankimore pasi i mungon legjitimitimi i ankuesit, pasi në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve është përfaqësuesi i Frymës së Re Demokratike Alfred Peto, gjithashtu kërkesa e nënshkruar nga Naçi Lato me cilësinë e përfaqësuesit të degës Memaliaj, kjo nuk e lëgjitimon kështu që kërkoj që të rrezohet kërkesa mos të kaloj për shqyrtim, faleminderit.

Z. E. Çefa: Zoti Lato ju autorizim të posaçëm për paraqitjen e kësaj kërkesë a keni?

Z. N. Lato: Po!

Z. E. Çefa: E keni me shkrim autorizimin? Sepse partia në emër të së cilës ju vini sot sikundër e tha edhe Sekretari i Përgjithshëm e ka një person të autorizuar dhe të atashuar këtu, që do të thotë që të gjitha ankimet që ju paraqisni për procesin

Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI



Seancë publike
Komisioni Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.05.2023

zgjedhor duhet të vijë në KAS nëpërmjet këtij personi, në rast të kundërt duhet të autorizoni ju pastaj vete, për ta ndjekur këtë rast vetë, që unë e kuptoj që ju nuk e keni një autorizim të tillë me shkrim.

Z. A. Peto: Autorizimin e kam me shkrim.

Z. E. Çefa: Ju lutem prezantohuni.

Z. A. Peto: Jam Alfredi, përfaqësues i Frymës së Re Demokratike, jam sekretar organizativ dhe unë jam personi që ndjek procesin deri në përfundim të procesit zgjedhor nga Fryma Demokratike i autorizuar për këtë. Tani ka ardhur ankesa këtu, unë e kam sjellë ankesën që e kam depozituar këtu në protokoll. Na u bë njoftimi dhe sot erdhëm. Ndoshta ndonjë gabim formal është bërë po për sa i përket vendimit që thatë ju më lart, nuk na e kanë dhënë vendimin. E kemi kërkuar në KZAZ atje, nuk është dhënë vendimi, përfaqësuesi jonë ka qënë me autorizim ka qënë vëzhgues atje me autorizim nga ana jonë. Nuk i është dhënë vendimi nga KZAZ-ja, pastaj të tjerat ne i kemi sqaruar edhe në ankesën që kemi paraqitur, vëllai numërontë për vëllain, motra numëronte për motrën, burri numërontë për gruan, një nga anëtarët nënprefekti i rrethit të Tepelenës, anëtar i grupit të numërimit, skandale nga me seriozet, na jepni një fotokopje i thamë, sna jepnin.

Z. E. Çefa: Dakord e kuptoj, jemi ende tek elementët formal për sa i përket legjitimitimit, dakord ju dhatë sqarimet e juaja por përveç kësaj unë shoh që kërkesa nuk ka bashkëlidhur as një provë, të paktën numrin e vendimit mund ta kishit cituar, mund ta kishit marrë edhe në KQZ, jo detyrimisht ta kishit kërkuar atje, por

Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI



Seancë publike
Komisioni Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.05.2023

mund ta kishit marrë këtu, e treta objekti i kërkimit paraqet probleme të karakterit të riformulimit, për shëmbull rinumërimi i kutive të KZAZ-së 78 është pak objekt shumë i gjerë, që ju në këtë fazë nuk mund ta kërkoni dhe ne po ashtu si KAS nuk mund ta realizojmë, ju duhet të indikoni vetëm ato qendra votimi, kutitë e të cilave i konsideroni me probleme duke argumentuar dhe duke provuar sepse keni edhe barrën e provës, duke provuar përpara KAS-it, se cilat janë arsyet që rezultati në kutit e votimit duhet rishikuar, për rrjedhojë edhe tabela përfundimtare duhet rishikuar, në këtë fazë nuk e shoh që i keni plotësuar megjithatë ne mund të japim kohë.

Z. A. Peto: Ne, kemi vrojtuar edhe qendrat e votimit, 15 qendra i kemi këtu ku i kemi përcaktuar qartë që në këto qendra duhet bërë rinumërimi e dyta nuk na jepni asnjë dokument. A e kuptoni se ku ndodhemi atje apo jo? Mirë që na lanë që hyri brenda, nuk na jepnin as fotokopje të procesverbali asnjë dokument sna jepnin, atje ishte nënprefekti me drejtorat, grupet e numërimit. Çdo bënim ne? Të bënim luftë? E kuptoni nw çfarë gjëndje është apo jo? Unë prandaj po them se nuk është problemi për një këshilltar, por të marri rrugë procesi edhe për të ardhmen, të vendoset ndonjë rregull tamam se po bëhet nami në Memaliaj, të marri rrugë procesi të bëhen zgjedhje të rregullta.

Z. I. Rusmaili: Keni bërë kërkesë në KQZ për tu pajisur me regjistrimin video për këto VNV-të që i kanë numëruar këto qendra votimi që kërkoni ju?

Z. N. Lato: Jo, skemi bërë.

Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI



Seancë publike
Komisioni Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.05.2023

Z. I. Rusmaili: Po e bëjë pyetjen sepse KAS-i nuk bënë rinumërim kështu siç e imagjinoni ju, nuk na e lejon ligji ne të bëjmë rinumërim, atje ku bëhet numërimi atje regjistrohet numërimi, edhe ju nëse kërkoni që ne eventualisht të hapim kutitë edhe t'i shikojmë do të vini me provën video, duke na thënë jo atë që thotë vëzhguesi, siç thoni ju, por duke thënë prova video regjistrimi në këtë sekuencë ,në këtë sekuensë, në këtë sekuencë tregon kaq vota për subjektin tonë, procesverbali tregon më pak, për këtë arsye kërkujmë që ta verifikoni nga kutia këtë provë dhe pastaj të vendosim në përputhje me... ju në këtë formë do të vini tæk ne, nuk vini dot kërkujmë rinumërim pastaj të shohim çfarë ndodh.Atë video e ka KQZ-ja nuk e ka perfektin atje, kërkesat i bëhen KQZ-së dhe KQZ-ja ka detyrimin tju pajisë, ne mund tju kthejmë me afat 24 orësh sa e kemi ne, që të bëni pjesën formale ta vini në emër të subjektit, jo në emrin tuaj, po Fryma e Re Demokratike subjekti elektoral bën kërkesë ankimore, të rregulloni objektin e kërkesës ankimore, jo dua rinumërim, po në përputhje me provat që dispononi të kërkoni konkretisht, çfarë doni në ndryshimin e rezultatit të tabelës dhe pastaj të shtoni këtu dhe provat. Vendimi nuk është më i rëndësishmi po janë provat e tjera ku do të mbështesni pretendimet më të rëndësishme, kështu do ta sjellim në formën e duhur gjënë që të mund të ecim përpara.

Z. A. Peto: Po e kërkujmë në KQZ këtë kasetën po na e dhanë edhe ata të shikojmë, se varet edhe ata do të kenë salsifikime siç po dëgjojmë këtu nga më të ndryshmet, sepse ata nuk na dhanë një cop letër jo të na jepnin kasetë.

Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI



Seancë publike
Komisioni Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.05.2023

Z. E. Çefa: I nderuar Sekretar Organizativ i Partisë, kjo që po themi ne këtu nuk është një justifikim, ky është ligji.

Z. A. Peto: Atëherë ne, meqë jemi këtu duhet të themi, që edhe ju duhet të na thoni që tek numërimi nuk janë trajnuar, nuk ka deklarata në kutitë e votimit që ata janë trajnuar, edhe ne po ju themi hetoni, ju si KAS hetoni se ne kaq kemi mundësi të mbledhim materiale.

Z. E. Çefa: Që ne ta hetojmë zotëri, se këtu kemi paqartësi për tu kuptuar bashkë, që ne ta hetojmë ju duhet ta sillni në atë formë që ligji e parashikon për të sjellë sepse kështu eventualisht mund të jetë e gjithë Shqipëria edhe vijnë me një kërkesë të numërojmë, ne nuk zëvendësojmë dot të gjithë numëruesit e Shqipërisë që t'i numërojmë, sapo ta tha kolegu të orjentoj, merr pamjet filmike që administrohen, këtu heto vetë, indiko vetë, edhe na thuaj në filan qendër votimi doli ky problem, kërkoj ta shihni ta verifikoni, po jo kështu shifini ju të gjitha se më duket se ka diçka aty, tani kjo është objektivisht e pamundur për ne, për këtë arsye ne po ju japim edhe një shanc tjetër, keni 24 orë kohë për të plotësuar dhe modifikuar kërkesën ankimore, në formën e kërkuar nga ligji dhe nesër do të takohemi sërish këtu për të verifikuar nëse i plotësoni elementët formalë dhe për të caktuar eventualisht seancën për shqyrtimin në themel të pretendimeve, atëherë nesër në orën 14:30 do të jetë sërish seanca paraprake që do tju kërkojmë deri atëherë t'i plotësoni të gjitha këto elemente formal të ankimit, faleminderit seanca deklarohet e mbyllur.

Vendimi nr. 129

Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.05.2023*

23.05.2023

Ora 13.51

RENDI I DITËS

**“Për shqyrtimin paraprak të kërkesës ankimore nr. 70, subjekti ankues Aleanca
Progresiste LZHK**

PJESËMARRJA:

- **KAS-i:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,
Z. Ledio Braho.
- **Stafi i KQZ-së:** Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema.
- **Parti Politike:** APLZHK (F. Topallari)

Z. L. Braho: Çelim seancën e shqyrtimit elementeve të formës dhe përmbajtjes të kërkesës ankimore nr. 70, depozituar nga subjekti ankimues Aleanca Progresiste LZHK, të depozituar në datën 22.05.2023 në KQZ, me objekt ankimi: rinumërimi i kutive të këshillit bashkiak me numër, janë cituar disa qendra votimi, ndryshimin e tabelës përmbledhëse të këshillit bashkiak të Pukës, sipas rezultatit të rinumërimit. Te vendimi citohet tabela përmbledhëse e KZHZ-së Pukë. Ka bashkëlidhur akte kjo? E kemi këtë vendimin e Pukës ne? E kemi. Është i njëjti që është edhe tek 63-shi. Mirë, atëherë i pranishëm është përfaqësuesi me autorizim i subjektit zgjedhor Partia Aleanca Progresiste LZHK, i pranishëm është sekretari i Përgjithshëm i

Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.05.2023*

KQZ-së. Zoti Merkaj, shkurtimisht çfarë qëndrimi keni në lidhje me elementet e formës dhe të përmbajtjes.

Z. Y. Merkaj: Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është paraqitur kërkesa ankimore me nr. 70, me objekt ankues LZHK-në, e cila kërkon ndryshimin e tabelës së rezultateve për këshillin bashkiak Pukë, sipas rezultatit të rinumërimit, seria e numërimit të kutive për këshillin bashkiak nr. 04-08, 04-15, 04-15/1 04-22, 04-24, 04-25 dhe 04-30. Nga verifikimi paraparak i kërkesës konstatohet se nuk i plotëson kërkesat e kërkuara nga neni 126 i Kodit Zgjedhor, pasi mungon referimi i vendimit që ankimohet. Në kërkesën ankimore nuk është as numri vendimit, as data. Në këto kushte kërkojmë mospranimin e kërkesës, moskalimin e kërkesës për shqyrtim. Faleminderit!

Z. L. Braho: Faleminderit, zoti Merkaj! Fjala për zotin Topollari, në lidhje me elemente të formës dhe të përmbajtjes.

Z. F. Topollari: Në gjykimin tim elemente të formës dhe përmbajtjes janë të përmbushura. Në objektin e kërkesës ne kundërshtojmë tabelën përmbledhëse dhe e kundërshtojmë atë pasi kërkojmë një hetim të thelluar të një grupi qendrash votimi. Nuk e kemi pasur numrin e vendimit që ka miratuar këtë tabelë përmbledhëse dhe kjo ka qenë arsyeja që nuk e kemi referuar datën e vendimit që ka miratuar tabelën përmbledhëse, po nga aspekti i thelbit unë mendoj që është e qartë kërkesa jonë. Administrata na referoi që tabelën përmbledhëse dhe vendimin

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.05.2023*

e ka përpara, praktikisht ne kundërshtojmë atë vendim me atë datë. Duke qene se nuk e zotërojmë, prandaj nuk e kemi shkruar numrin e vendimit.

Z. L. Braho: Po, faleminderit! Në lidhje me provat, çfarë provash keni, se këtu në kërkesë citoni pjesën e vëzhguesve të huaj, që kanë vënë re një sërë parregullsish në momentin e numërimit për këto qendra votimi?

Z. F. Topollari: Sipas raportimeve të tyre, në këto qendra votimi ka pasur devijim, pra midis votave që kanë dalë në ekran dhe janë lexuar për LZHK-në ose për partitë e tjera, që kanë fituar mandatin, me rezultatin e procesverbalit përfundimtar. Në fakt, grupi ynë i vëzhguesve, që ka bërë hetimin në këtë çështje, ka bashkëpunuar ngushtësisht me Partinë Aleanca Demokristiane. Ata duke qenë se ishin përpara kanë tërhequr edhe provat filmike dhe këto prova janë studiuar edhe nga ana jonë dhe gjithashtu dhe provat filmike që janë depozituar te kërkesa e Partisë Aleanca Demokristiane, në mos gaboj, për të njëjtën KZAZ, me të njëjtin objekt janë paraqitur në kërkesën e tyre. Prova jonë kryesore dhe fillestare, në momentin që kemi hartuar kërkesën, kanë qenë vëzhguesit tanë, të cilët kanë konstatuar që në këto kuti votimi ka pasur mospërputhje midis votave që kanë dalë për subjektin tonë zgjedhor dhe të tjerët me votat që janë pasqyruara në procesverbalin përfundimtar. Janë të njëjtat qendra votimi po.

Z. I. Rusmali: Referencat që tregojnë votat tuaja eventualisht, nëse pretendoni tjetërsim votash, brenda një numërimi për një qendër votimi, pra jo një orë filmim,

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.05.2023*

por 30 sekonda sekuenca, 50 sekonda sekuenca, të cilat ne mund t'i konfrontojmë me tabelën e rezultatit të qendrës së votimit dhe të kuptojmë ka apo nuk ka diskordanca. Kjo është provë që duhet ta qëmtoni ju, nuk e qëmtojmë ne. Se duket sikur e ka bërë partia tjetër.

Z. F. Topollari: Në fakt, e kanë bërë së bashku vëzhguesit tanë me të partisë tjetër.

Z. I. Rusmali: Edhe një herë, raporti i vëzhguesit nuk është provë, është pretendim, sepse është i yti. Ti mund të krijosh çfarëdolloj raportesh të duash.

Z. F. Topollari: Këtë e kuptova. Ajo që po thosha është se provat filmike i ka dorëzuar partia tjetër, sepse kemi marrë vetëm një palë prova filmike, i ka marrë e para partia tjetër, kemi punuar bashkë mbi ato prova, dhe janë dorëzuar te kërkesa e parë dhe nuk kemi menduar të dorëzojmë të njëjtat prova filmike.

Z. I. Rusmali: Edhe unë po them këtë që prova filmike nëse është një regjistrim video prej 10 orësh nuk është kjo prova filmike. Prova filmike janë të gjitha sekuenat, kuadrot ku në ekran shfaqen votat tuaja për një qendër votimi. Të gjitha sekuenat. Do të na thoni në numrin e qendrës së votimit fillon në sekondën kaq dhe mbaron në sekondën kaq. Në këtë sekondë, në këtë sekondë, në këtë sekondë janë votat tona që të mund të kontrollojmë. Nuk shohim ne 10 orëshin do ta shohësh ti 10 orëshin dhe do ta sjellësh me sekuenca. Kjo është provë për ne. Mos

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.05.2023*

thuaj regjistrimi video është depozituar nga pala tjetër, sepse regjistrimet video i aknë të gjitha këta, nuk do të kishit nevojë po të ishte kështu të depozitohet gjë. Ju duhet ta shikoni dhe ta evidentoni çdo votë, nëse keni pretendimin për votat tuaja, dhe të na e thoni ne ditën që ne shqyrtojmë.

Z. F. Topollari: Njerëzit që janë marrë me këtë hetim kanë konstatuar që në këto kuti ka devijim jo vetëm të votave tona, pra jo vetëm janë hequr votat tona, por ka edhe ndryshim të votave të subjekteve të tjera.

(Diskutim pa mikrofon)

Jo, por ajo ka hequr mandatin e subjektit tonë. Pra, fakti që votat e një subjekti i kanë kaluar një subjekti tjetër ka rritur votat e atij subjekti në rastin e Pukës, në mos gaboj, PSD-ja, në mos gaboj.

Z. I. Rusmali: Është e thjeshtë se bashkë kuptohemi do të provoni për cdo votë të subjektit tjetër që me atë votë është cenuar nëj interes i ligjshëm i juaji që të mund ta trajtojmë këtë ne.

Z. F. Topollari: Në kërkesën që ne kemi hartuar dhe në vëzhgimin që i kemi bërë edhe pamjeve video ne na rezulton që numri i votave që i janë hequr subjektit tonë në këto kuti votimi duke shtuar edhe numrin e votave që i janë shtuar subjektit që ka marrë mandatin që ne pretendojmë se është i joni është më i madh se diferenca midis marrjes së mandatit.

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.05.2023*

Z. I. Rusmali: Këtë duhet ta provoni, kur të vini këtu. Pra, nuk e provon kërkesa për rinumërim, e provoni ju dhe pastaj ne bëjmë verifikimin eventualisht edhe duke numëruar vota të caktuara. Ky është rregulli.

Z. F. Topollari: Në gjykimin tim unë mendoj se ne e kemi provuar nga pamjet filmike që kemi parë për këto kuti. Nuk e kemi specifikuar me numër votash për secilin subjekt për hir të së vërtetës, por unë në kërkesën e depozituar është paraqitur që diferenca midis mandateve është 35 ndërsa votat e devijuara në këtë mënyrë në na rezultojnë më shumë se 35.

Z. L. Braho: Ilirjan, nesër është seanca, të sjellë provat që ka për të sjellë, sepse po përsërisim të njëjtat gjëra. Fabjan, besoj se je i qartë se çfarë duhet të sjellësh nesër për të plotësuar barrën e provës që të arrijmë në vendim. A ka ndonjë pyetje nga kolegët? KAS-i i konsultuar në vend vendos kalimin për shqyrtim administrativ të kërkesës ankimore numër 70 të depozituar nga ankuesi Partia Aleanca Progresiste LZHK. Në bazë të nenit 130 të Kodit Zgjedhor kjo kërkesë ankimore do të shqyrtohet bashkërisht me kërkesën ankimore numër 63 dhe për shkak të faktit se kanë të bëjnë me tabelën përmbledhëse të rezultatit për KZAZ-në Pukë dhe seanca do të zhvillohet nesër, më datë 24 maj 2023, në ora 12:30. Seanca deklarohet e mbyllur.

Vendimi nr. 130

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.05.2023*

23.05.2023
Ora 13.51

RENDI I DITËS

**“Për bashkimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 63 dhe 70, subjekti ankues
Aleanca Progresiste LZHK”.**

PJESËMARRJA:

- **KAS-i:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,
Z. Ledio Braho.
- **Stafi i KQZ-së:** Z. Ylli Merkaaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema.
- **Parti Politike:** APLZHK (F. Topollari)

Z. L. Braho: KAS-i i konsultuar në vend vendos kalimin për shqyrtim administrativ të kërkesës ankimore numër 70 të depozituar nga ankuesi Partia Aleanca Progresiste LZHK. Në bazë të nenit 130 të Kodit Zgjedhor kjo kërkesë ankimore do të shqyrtohet bashkërisht me kërkesën ankimore numër 63 dhe për shkak të faktit se kanë të bëjnë me tabelën përmbledhëse të rezultatit për KZAZ-në Pukë dhe seanca do të zhvillohet nesër, më datë 24 maj 2023, në ora 12:30.

Seanca deklarohet e mbyllur.

Vendimi nr. 131

Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.05.2023*

23.05.2023
Ora 14.03

RENDI I DITËS

**Projektvendim “ Për shqyrtimin paraprak të kërkesës ankimore nr. 72,
subjekti ankues: Lame Jaupaj APLZHK”**

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,
Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema.
- **Parti politike:** APLZHK (Fabian Topollari)
- **Të tjerë:** KRIIK

Z. I. Rusmali: Kalojmë te shqyrtimi paraprak i kërkesës ankimore numër 72. Sipas kërkesës ankimore kërkesa paraqitet nga Lame Jaupaj i Aleancës Progresiste LZHK. Objekti i ankimit është rinumërimi i kutive të këshillit bashkiak KZAZ 78. Prezent janë: sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së me ekipin e tij; përfaqësuesi i subjektit.

Z. F. Topollari: Po, jam përfaqësuesi i subjektit.

Z. I. Rusmali: Dhe është edhe vetë zoti Lame.

Z. F. Topollari: Që ka bërë ankesën dhe që do të jetë nevoja ta plotësojmë.

Z. I. Rusmali: Kërkesa paraprake për trupën nuk keni. Zoti Merkaj, a mund të na jepni informacionin paraprak lidhur me këtë kërkesë?

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.05.2023*

Z. Y. Merkaj: Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është paraqitur kërkesa ankimore numër 72, nga ankuesi Lame Jaupaj, përfaqësues i Aleancës Progresiste LZHK, i cili kërkon rinumërimin e kutive të këshillit bashkiak KZAZ-së numër 78, Bashkia Memaliaj. Nga verifikimi paraprak e kërkesës konstatohet se nuk plotësohen elementet formale të kërkesës, pasi nuk plotëson legjitimitimin e ankuesit për të paraqitur këtë kërkesë, gjithashtu, dhe kërkesës i mungon baza ligjore, referimi vendimit ku ankimohet, ku ushtrohet ankimimi. Në këto kushte i kërkojmë KAS-it moskalimin e kërkesës në seancë për shqyrtim.

Z. I. Rusmali: A ka pyetje nga kolegët?

(Diskutime pa mikrofon)

Ju kërkon pa diskutim shqyrtimin, besoj?

Z. F. Topollari: Po, i nderuar, dhe menjëherë do të bëjmë plotësimet e nevojshme, të nënshkruhet në emër të subjektit.

Z. I. Rusmali: Mirë ne marrim vendim. KAS-i i konsultuar në vend vendosi që ta kthejë për plotësim këtë kërkesë me qëllim që të rregullohen elementet e formës dhe të përmbajtjes, të sillen aty ku duhet. Kërkesa të vijë nga subjekti zgjedhor. Të rregullohet objekti i ankimit në përputhje me Kodin Zgjedhor. Pastaj përshkrimi dhe provat në përputhje me objektin e ankimit. Kjo të sillet nesër në ora 14:40 për të bërë shqyrtimin paraprak. Pra, plotësimi të bëhet deri nesër në orën 14:40. Nesër në këtë orë KAS-i do të mblidhet për të bërë shqyrtimin paraprak të kërkesës. Me kaq seanca mbyllet. Faleminderit!

Z. F. Topollari: Faleminderit!

Vendimi nr. 132

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*

